



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1221/9 prot.

Datë 10.06.2025

**V E N D I M**

**Nr. 755/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 10.06.2025 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Albania Distribution Chemicals*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-44265-04-09-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit natriumi për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 6,624,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 22-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “2AT” SHPK me NIPT K14019001H dhe adresë një magazinë me sip 2987 m<sup>2</sup>, në Bare (Barç), Korçë, zona kadastrale 1101

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A. Qafë-Gjashtë, Sarandë, Rruga “Skënderbeu

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “*Albania Distribution Chemicals*” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë Tiranë, Rruga e Kavajës, Buka sh.a, Nr. 8240, Njësia nr.6.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10-04-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-44265-04-09-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit

natriumi per nevojat e shoqerise”, me fond limit 6,624,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 22-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.

II.2. Në datën 22-04-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

II.3. Në datën 28.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                                        |                  |              |             |
|----------------------------------------|------------------|--------------|-------------|
| 1. 2 AT SHPK                           | <b>4,968,000</b> | lekë pa tvsh | kualifikuar |
| 2. Albania Distribution Chemicals shpk | <b>4,968,000</b> | lekë pa tvsh | kualifikuar |
| 3. ATLANTIK 3 Shpk                     | <b>6,622,160</b> | lekë pa tvsh | kualifikuar |

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, më datë 06.05.2025, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak

II.5. Në datën 12.05.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1221/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5303 e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-44265-04-09-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit natriumi per nevojat e shoqerise”, me fond limit 6,624,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 22-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1221/1 prot., datë 13.05.2025.

II.7. Me shkresën me datë 19.05.2025, me lëndë “Dërgim vendimi”, dërguar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1221/3 prot., datë 19.05.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A ka dërguar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “2AT” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.8 Me shkresën me nr. 1221/5 prot., datë 28.05.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, Shoqërisë Rajonale Ujësjellës

Kanalizime Sarandë SH.A, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.9. Me shkresën me nr. 397/1 prot., datë 29.05.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1221/6 prot., datë 02.06.2025 autoriteti kontraktor Shogëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë Sha.A ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se janë dorëzuar argumente nga subjektet e interesuara në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “2AT” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK me pretendimin se: *“Lidhur me pikën 2.3.5 “2.3.5 Operatori ekonomik ose furnitori i tij duhet të garantojë sasinë e produkteve të prokuruar në këtë procedurë nëpërmjet, (a) nëse është prodhues me një deklaratë të tij, (b) nëse është tregtues duhet të disponojë një kontratë me prodhuesin për sasinë e prokuruar të barabartë ose me të lartë nga ajo e kërkuar në këtë procedurë. Afatet e kontratave duhet të jenë të vlefshme në periudhën e zhvillimit të procedurës. Firma 2 AT pretendon se “Albania Distribution Chemicals” nuk ka një kontratë me prodhuesin ose një kontratë me furnitorin duke paraqitur lidhjen midis tyre. Në kemi dyshimet tona që egziston një mospërputhje midis të dhënave, emrit të prodhuesit që kjo firmë ka lidhur kontratën (nëse egziston) dhe lejes së importit që ai ka paraqitur në dokumentat e tenderit. Kërkojmë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga “Albania Distribution Chemicals”, mosplotësimi i kësaj pike e bën këtë ofertë të pavlefshme dhe kusht për skualifikim bazuar dhe në vendimi Nr. 510/2025 Datë 15/04/2025 Në rast se operatori ekonomik është importues, atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik, Lejen e Importit të leshuar nga*

*Komisioni i Licensave prane Ministrise se Shendetesise per llojet e sasive e kimikateve te percaktuara ne DST. Kërkojmë verifikimin e lejes të importit në rast se ajo ekziston”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1 Në pikën 2.3.5 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*2.3.5 Operatori ekonomik ose furnitori i tij duhet te garantoje sasine e produkteve te prokuruar ne kete procedure nepermjet, (a) nese eshte prodhues me nje deklarate te tij, (b) nese eshte tregtues duhet te disponoje nje kontrate me prodhuesin per sasine e prokuruar te barabarte ose me te larte nga ajo e kerkuar ne kete procedure. Afatet e kontratave duhet te jene te vlefshme ne periudhen e zhvillimit te procedures.*

III.1.2. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të produktit objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

*Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht : Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013*

##### **1.Specifikimet teknike te kimikateve per trajtimin e ujit te pijshem.**

*Procesi teknologjik i trajtimit te ujit te pijshem realizohet me perdorimin e Hipokloritit te Natriumit 13-15% i cili sherben si oksidues dhe densifektues.*

*Hipokloriti I Natriumit(NaOCL) qe do te perdoret per ujin e pijshem si komponim kimik,duhet te jete me parametra fiziko-kimike ne perputhje me vlerat parametrike te shprehura ne rregulloren: “CILESIA E UJIT TE PISHEM”MIRATUAR ME V.K.M NR.379 DATE 25.05.2016*

##### **A. Hipoklorit Natriumi (NaOCL)**

*1.Lende e paste rkimikisht*

*2.Lende me perqenrim klor aktiv ,13-15%*

*3.Lenda duhet te jete e shoqeruar me dokumenta si me poshte:*

*a.Certifikate cilesie e marre ne vendin ku eshte prodhuar kjo lende (e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar nqs vjen nga jashte)*

##### **2.Specifikat e automjetit qe do te shërbejë për furnizimin e kimikateve**

*1.Furnizimi me kimikate do të kryhet me mjet tip autobot ose kamion te certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Çisternat e botit apo depozitat e kamionit për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatëshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm.Automjeti qe sherben per transportin e kimikateve duhet te jete i*

*pajisur me certifikate ADR „PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME“ (KIMIKATE)*

## **2.Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave**

*Furnizimi i Hipokloritit të Natriumit do të bëhet sipas kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujesjelles -Kanalizime Sh.a Sarandë, por përgjithësisht me sasi proporcionale rreth 10.000kg në mënyrë periodike, përafërsisht çdo dy-tre muaj. Furnizimi do të njoftohet për këtë ,7(shtatë) ditë përpara në formë shkresore ose elektronike .Në ndojë rast ,furnizuesi duhet të jetë i përgatitur që të plotësojë edhe ndojë kërkesë me urgjente , të Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarandë sh.a .*

## **3.Kontrolli i cilësive dhe sasive të ngarkesave të kimikateve**

*Në ditën e dorëzimit të ngarkesës, do të merren nga ngarkesa me përzgjedhje të pakten 3(tre) kampjone, të cilat do të vendosen në enë të përshtatshme , të vëlosura dhe të firmosura nga marresi dhe transportuesi, dhe nga të cilat 1(një)do të dorëzohet nepermjet autotransportuesit firmës furnizuese dhe 2(dy)laboratorit fiziko -kimik të Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarandë sh.a ,për analizë e verifikime. Njëra nga 2(dy)kampjonet do të ruhet për kontrollin e analizës përfundimtare në rast kundërshtimi të furnizuesit. Në një situatë të tillë të dy palet do të ndjekin bashkërisht kontrollin e analizave, mbi kampjonin e vëlosur si dhe atë të firmës furnizuese në qoftë se mbi atë nuk është vënë dore, e të nënshtrohen marrëveshjes së arsyeshme. Firma furnizuese që nga momenti në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësive të ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën , ka 10(dhjetë)dite kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.*

*Për kontrollin e sasive, komisioni i marrjes në dorëzim do të hartojë procesverbalet përkatëse.*

## **4. Dokumentacioni shoqëruar i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit**

*Firma furnizuese përpara se të realizojë shkarkimin e kimikateve për çdo ngarkesë të dorëzuar duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm*

- 1- Çertifikatën e origjinës ku jepet origjina e produktit, në origjinal ose kopje të noterizuara*
- 2- Fletë -analiza e prodhuesit për sasinë e kimikatit të ofruar, në origjinal ose kopje të noterizuara*
- 3- Raport Analizën të lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror , në origjinal ose kopje të noterizuara*
- 4- Për kimikatin e furnizuar duhet të paraqitet skeda e sigurisë në origjinal ose kopje të noterizuara*
- 5- Duhet të paraqitet që me ngarkesën e parë të produktit të furnizuar Leja e Importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për Hipokloritin e Natriumit ( e noterizuar)*

## 5-Per shpenzimet

*Te gjitha shpenzimet duke perfshire ato, te transportit dhe shkarkimit te kimikateve ne magazinën e Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a si dhe te analizave qe do te kryhen perkatesisht per cdo ngarkese dhe parti malli nga nje institucion shteteror, si Instituti i Shendetit Publik ose nje institucion i kredituar ne vend do te jete ne ngarkim te firmes fituese.*

III.1.3. Për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.5 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues “Albania Distribution Chemicals” SHPK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) për përmbushjen e këtyre kriterëve kualifikuese ka dorëzuar përkatësisht dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- AKT I AUTORIZIMIT TË PRODUKTIT BIOCID NR. 7, DATË 02/04/2024, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.104, datë 27.02.2024 “Për caktimin e fushës së përgjegjësisë së zëvendësministrave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, dhe me rekomandim të Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide, duke vendosur:

*Autorizimin e vendosjes në treg dhe përdorimin e produktit biocid me karakteristikat e mëposhtme:*

- 1) *Emrin tregtar i produktit biocid – Hipoklorit Natriumi*
- 2) *Emrin dhe adresën e personit fizik ose juridik mbajtës i autorizimit – “Albania Distribution Chemicals” Shpk, Rruga e Kavajës, Buka Sh.a, Nipt: M11815028I;*
- 3) *Data e lëshimit të autorizimit dhe data e skadimit – 2.04.2024 –2.04.2026;*
- 4) *Numri i autorizimit të produktit biocid – Nr.7;*
- 5) *Përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jo vepruese si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid – Hipoklorit Natriumi 13-15 %*
- 6) *Prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit) – “CargoChem Adria d.o.o Sloveni”, Linjat e prodhimit - Itali;*
- 7) *Prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit);*
- 8) *Tipi i formulimit të produktit biocid;*
- 9) *Frazat e rrezikut dhe parandalimit;*
- 10) *Tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; Lëndë për trajtimin e ujit të pijshëm*
- 11) *Organizmat target;*
- 12) *Dozat e aplikimit dhe udhezimet për përdorimin;*

- 13) Kategoritë e përdoruesve;
- 14) Të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis;
- 15) Udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit;
- 16) Kushtet e ruajtjes dhe jetëgjatësinë e produktit biocid për kushte normale të ruajtjes;
- 17) Informacion tjetër relevant rreth produktit biocid.

- Dokumentin datë 03.01.2024, lëshuar nga kompania Chargochem Adria doo me vendndodhje Beograd, Serbi, për shoqërinë 'Albania Distribution Chemicals, me përmbajtjen si në vijim: *"Ne konfirmojmë se kompania Chargochem Adria doo ka hedhur në treg karbonin aktiv I cili është UNI EN 900:2014, Hipoklotit Natriumi I cili është conform me UNI EN 901:2013, Acidi Klorhidrik I cili është conform me UNI EN 939:2016, Klorur poli Alumini (PAC) I cili është conform me UNI EN 17034:2018, acidi sulfuric I cili është conform me UNI EN 899:2009, I përshtatshëm për përdorim në trajtimin e ujit të pijshëm, si dhe autorizojmë kompaninë shqiptare, Albania Distribution Chemicals, të tregtojë këtë product brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ne vëmë në dispozicion përdorimin e të gjithë dokumentacionit për këtë product. Ne gjithashtu marrim përsipër të furnizojmë klientët tanë në sasi si më poshtë:*

*Sasia për çdo vit:*

*Karbon aktiv: 400 ton*

*Hipoklorit kalciumi: 1000 Ton*

*Hipoklorit Natriumi: 3000 Ton*

*Acid Hidroklorik: 3000 Ton*

*Klorur Poli Alumini (PAC): 2000 ton*

*Acid sulfuric: 400 ton*

*Periudha e vlefshmërisë së kontratës 03.01.2024-03.01.2029.*

III.1.4. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

Ndërkohe në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në"*



mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

III.1.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për mallrave”, pika 5 dhe pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) 20 Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar,

si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.7. Në nenin 3 “Fusha e veprimit”, nenin 8 “Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide” dhe nenin 9 “Vendosja në treg e produkteve biocide” të ligjit nr. Nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Neni 3 Fusha e veprimit “1. Ky ligj zbatohet për: a) përdorimet, në shëndetin publik, të produkteve biocide; b) produktet që shkatërrojnë, pengojnë apo kthejnë në të padëmshëm organizmat e dëmshëm për shëndetin, përmes rrugëve kimike ose biologjike të veprimit. 2. Ky ligj nuk zbatohet për: a) përdorimet jobiocide të produkteve dhe lëndëve vepruese; b) produktet që shkatërrojnë, pengojnë apo kthejnë në të padëmshëm organizmat e dëmshëm për shëndetin publik, nëpërmjet rrugës fizike të veprimit dhe jo rrugëve kimike ose biologjike; c) produktet e rregulluara me akte të tjera ligjore, si: produktet e mbrojtjes së bimëve, barnat mjekësore për përdorim human, barnat mjekësore për përdorim veterinar, pajisjet mjekësore, lëndët kozmetike. 3. Parashikimet e këtij ligji nuk bien ndesh me dispozitat e legjislacionit përkatës që trajton çështje që kanë lidhje me produktet biocide”.

Neni 8 Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide “1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent. 2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji. 3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuar, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës. 4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për: a) produkte biocide të prodhuara në vend; b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi; c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e Ballkanit. 5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të

Këshillit të Ministrave. Neni 9 Vendosja në treg e produkteve biocide 1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. 2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik; b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit; c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit; ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

III.1.8. Në Kreun II “PROCEDURA E DHËNIES SË AUTORIZIMIT TË VENDOSJES NË TREG TË PRODUKTEVE BIOCID” dhe Kreun III “PËRMBAJTJA E DOSJES SË APLIKIMIT PËR AUTORIZIM” të VKM nr. Nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, parashikohet shprehimisht se:

KREU II PROCEDURA E DHËNIES SË AUTORIZIMIT TË VENDOSJES NË TREG TË PRODUKTEVE BIOCID “1. Autorizimi për vendosjen në treg të një produkti biocid në Republikën e Shqipërisë kryhet vetëm kur lëndët vepruese në përbërje të produktit përfshihen në listat e lëndëve vepruese të miratuara dhe vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

2. Listat e lëndëve vepruese e përcaktuar në shtojcën V të këtij vendimi përbëhet nga lista e lëndëve vepruese në përbërje të produkteve biocide që janë subjekt i procedurës të autorizimit dhe lista e lëndëve vepruese në përbërje të produkteve biocide që janë subjekt i procedurës të thjeshtuar të autorizimit. Listat përditësohen sa herë që ka ndryshime të legjislacionit të BE-së lidhur me lëndët vepruese për produktet biocide, por jo më pak se një herë në vit.

3. Për t’u pajisur me autorizim për vendosjen në treg të një produkti biocid, në përputhje me kërkesat e pikës 1, të këtij kreu, aplikanti dorëzon dosjen e referuar në kreun III, të shtojcës I, të këtij vendimi, pranë Sekretariatit të Autorizimit të Produkteve Biocide, strukturë pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Sekretariati shqyrton paraprakisht kërkesën dhe dosjen e aplikimit për autorizim të produktit biocid lidhur me përmbushjen e kriterëve të vlerësimit e në përfundim:

a) njofton subjektin se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës;

b) njofton subjektin për plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kriterëve të vlerësimit, brenda 20 ditëve nga dita e marrjes në dorëzim të dosjes, ku i paraqiten edhe arsyet e mospranimit ose kërkesat për të dhëna shtesë. Subjekti plotëson të metat lidhur me plotësimin e kriterëve të vlerësimit, brenda 7 ditëve nga dita e kthimit të dosjes. Nëse subjekti nuk njoftohet brenda këtij intervali kohor për mangësitë e dosjes së aplikimit dhe, si rrjedhojë, mospranimin e aplikimit, aplikimi konsiderohet i pranuar.

5. Në rastet kur përmbushen kërkesat e pikës 4, të këtij kreu, dosja me dokumentacionin teknik në formë elektronike (CD), i dërgohet për vlerësim Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), brenda 25 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të dosjes.

6. Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), si strukturë e specializuar, bën vlerësimin e produktit/eve biocid/e, bazuar në informacionin e paraqitur në dosje që përfshin: rezultatet e studimeve toksikologjike dhe efektivitetit të lëndës vepruese dhe të përbërësve të tjerë, si edhe ndikimit në mjedis, simbolet, frazat e rrezikut dhe të sigurisë, klasifikimin, etiketimin dhe paketimin në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet dhe biocidet, si edhe dokumentin e të dhënave të sigurisë së kimikateve (MSDS).

7. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, Instituti i Shëndetit Publik përgatit raportin e vlerësimit për vendosjen në treg të produktit biocid dhe e dërgon atë pranë Sekretariatit, brenda 30 ditëve.

8. Sekretari përgatit materialin përmbledhës për mbledhjen e komisionit, brenda 10 ditëve nga ardhja e mendimeve të ISHP-së.

9. Komisioni shqyrton dosjen dhe zhvillon mbledhjen brenda 30 ditëve. Bazuar në mendimin e komisionit, kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit, jep mendimin me shkrim për dhënien ose refuzimin e autorizimin për vendosjen e produkteve biocide në treg dhe përdorimin e tyre. Autorizimi lëshohet apo refuzohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Në rast refuzimi të produktit biocid, komisioni arsyeton vendimin e marrë dhe Sekretariati njofton aplikantin brenda afateve ligjore.

10. Sekretariati përgatit aktin e autorizimit për vendosjen në treg për çdo produkt biocid, me përmbajtje sipas formatit të përcaktuar në shtojcën IV, bashkëngjitur këtij vendimi.

11. Akti i autorizimit të vendosjes në treg të produktit biocid regjistrohet në një regjistër të veçantë në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, i cili administrohet nga Sekretariati i Autorizimit të Produkteve Biocide. Autorizimi publikohet edhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

12. Sekretariati përgatit listën e produkteve biocide të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe e publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

13. Tarifat administrative për t'u pajisur me autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide përballohen nga aplikantët dhe derdhen në buxhetin e shtetit. Tarifat administrative përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

14. Autorizimi lëshohet për një periudhë 2-vjeçare.

15. Vendimi për refuzimin e autorizimit mund të ankimohet, sipas parashikimeve në ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

### KREU III PËRMBAJTJA E DOSJES SË APLIKIMIT PËR AUTORIZIM

1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:

a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi;

b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis; - udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjetër relevant rreth produktit biocid.

c) Një dosje dhe letër aksesit për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;

ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit.

d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla;

dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuar. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe;

e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi: - një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi; - të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe.

ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”;

f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet.

- g) *Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg;*
- gj) *Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide;*
- h) *Lejen mjedisore, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;*
- i) *Faturën e pagesës së aplikimit.*

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nga shqyrtimi i shtojcës 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e produktit objekt prokurimi ku në rastin konkret është “Hipokloritit te Natriumit”, i cili është i nevojshëm për trajtimin e ujit të pijshëm për banorët e Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarandë sh.a, si dhe ka përcaktuar specifikimet teknike të këtij produkti duke përcaktuar se ky produkt duhet të përmbushë standartet S SH EN 901: 2013. Autoriteti kontraktor për tu siguruar se operatorët ekonomikë ofertues kanë aftësinë teknike dhe profesionale për të realizuar furnizimin me produktin “Hipokloritit te Natriumit” sipas një standardi të përshtatshëm cilësie ka përcaktuar ndër të tjera kriteret kualifikuese si më poshtë vijon: Në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar që: “*Operatori ekonomik ose furnitori i tij duhet të garantojë sasinë e produkteve të prokuruar në këtë procedurë nëpërmjet, (a) nëse është prodhues me një deklaratë të tij, (b) nëse është tregtues duhet të*

*disponoje nje kontrate me prodhuesin per sasine e prokuruar te barabarte ose me te larte nga ajo e kerkuar ne kete procedure. Afatet e kontratave duhet te jene te vlefshme ne periudhen e zhvillimit te procedures”.*

III.1.11. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimes “2 AT” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, Komisioni konstaton se në fazën e ofertimit operatori ekonomik ofertues “Albania Distribution Chemicals” SHPK për produktin objekt prokurimi ka ofertuar produktin “Hipoklorit natriumi” të prodhuar nga kompania “CargoChem Adria doo”, Beograd, Serbi, sipas deklaratës datë 03.01.2024, të lëshuar nga ky prodhues në favor të ofertuesit, si dhe ky ofertues ka paraqitur AKT I AUTORIZIMIT TË PRODUKTIT BIOCID NR. 07, datë 02.04.2024, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në favor të ofertuesit, ku konstatohet se ofertuesi është i autorizuar të vendosë në treg dhe përdorim produktit biocid “hipoklorit natriumi” të prodhuar nga kompania “CargoChem Adria” d.o.o. Sloveni”. Nisur nga ky dokumentacion i dorëzuar nga ankimesi, Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK është një kompani që e importon produktin objekt prokurimi dhe referuar kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe referuar legjislacionit sektorial për vendosjen në treg të produkteve biocide duhet të paraqesë autorizim të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për produktin “Hipoklorit Natriumi” të prodhuar nga kompania “CargoChem Adria doo. Referuar dokumentacionit të ofertës të sipërpërmendur ky ofertues ka dorëzuar në SPE autorizim të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për produktin “Hipoklorit natriumi” të prodhuar nga kompania sllovene “CargoChem Adria” d.o.o. Nisur nga përcaktimet e nenit 3, nenin 8 dhe nenin 9 të ligjit nr. Nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, i ndryshuar, Komisioni konstaton se çdo produkt biocid për përdorim në shëndetin publik duhet të jetë i pajisur me autorizim të lëshuar nga organi kompetent, ku referuar përcaktimeve të Kreut II “PROCEDURA E DHËNIES SË AUTORIZIMIT TË VENDOSJES NË TREG TË PRODUKTEVE BIOCID” dhe Kreut III “PËRMBAJTJA E DOSJES SË APLIKIMIT PËR AUTORIZIM” të VKM nr. Nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” organi kompetent për lëshimin e këtij autorizimi është Sekretariati i Autorizimit të Produkteve Biocide, strukturë pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, duke përcaktuar jo vetëm dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja e dorëzuar nga aplikanti dhe procedurën e pajisjes me autorizim, por edhe formatin e aktit të autorizimit në të cilin evidentohen ndër të tjera emri i kompanisë mbajtëse e autorizimit, emri i produktit biocid që autorizohet të vendoset në treg dhe emri i kompanisë prodhuese të produktit biocid. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni konstaton se në dokumenti i ngarkuar në SPE në momentin e ofertimit, Deklaratë, datë 03.01.2024 është lëshuar nga shoqëria Cargo Chem d.o.o, Beograd, Serbi, e cila autorizon kompaninë “Albania Distribution Chemicals” SHPK të tregtojë ndër të tjera produktin hipoklorit natriumi në territorin e Shqipërisë, ndërsa referuar aktit të

autorizimit nr. 7, datë 02/04/2024 lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezulton se autorizimi i vendosjes në treg dhe përdorimin e produktit biocid hipoklorit natriumi, rezulton se prodhuesi i produktit biocid është “CargoChem Adria d.o.o Sloveni”.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni gjykon se, referuar kriteret të veçanta të kualifikimit, si dhe legjislacionit sektorial për produktin biocid të ofruar operatorit ekonomik ofertues duhet që njëkohësisht të paraqesë dhe autorizimi përkatës i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku të pasqyrohet emri i produktit biocid të ofertuar për të cilin lëshohet autorizimi dhe emri i kompanisë prodhuese të produktit biocid, ndërkohë që referuar dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga operatorit ekonomik importues “Albania Distribution Chemicals” SHPK konstatohet se ka ofruar produktin biocid për përdorim njerëzor “Hipoklorit natriumi” të prodhuar nga kompania Serbe “CargoChem Adria d.o.o”, ndërkohë që për këtë produkt nuk ka paraqitur autorizim të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por ka paraqitur AKT I AUTORIZIMIT TË PRODUKTIT BIOCID NR. 07, datë 02/04/2024, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në favor të ofertuesit, ku konstatohet se ofertuesi është i autorizuar të vendosë në treg dhe përdorim produktit biocid “Hipoklorit natriumi” të prodhuar nga kompania shqiptare “CargoChem Adria” d.o.o, duke mosplotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Akoma më tej referuar dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën me nr. 397/1 prot., datë 29.05.2025, Komisioni konstaton se, operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Sarandë SH.A, dokumentin deklaratë datë 03.01.2024 lëshuar nga shoqëria CargoChem Adria doo, Beograd, Serbi në emër të shoqërisë “Albania Distribution Chemicals” SHPK, aktin e autorizimit nr. 7, datë 02/04/2024 lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe dokumentin deklaratë datë 03.01.2024 lëshuar nga shoqëria CargoChem Adria doo, Sloveni, dokument i cili nuk është dorëzuar nga operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në momentin e ofertimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “2 AT” SHPK qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “2AT” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me arsyetimin se: “[..] Kjo firmë nuk disponon mjetet e nevojshme me certifikatë ADR për transportin e mallrave të rrezikshme për realizimin e kësaj kontrate në bazë të specifikimeve teknike dhe grafikut të lëvrimin ku sasia është 10.000 kg cdo dy tre muaj. Pra kjo firmë nuk plotëson kushtet e kapacitetit teknik mbajtes mbi 10.000 kg. Kërkojmë nga ana juaj verifikimin e plote të dokumentacionit të paraqitur nga “Albania Distribution Chemicals” në këtë procedurë prokurimi sepse kemi dyshimet tone që dokumentacioni nuk është paraqitur i plotë bazuar në shtojcë 9 vetdeklarimi.



2.Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve 1.Furnizimi me kimikate do të kryhet me mjet tip autobot ose kamion te certifikuar për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. çisternat e botit apo depozitat e kamionit për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm.Automjeti qe sherben per transportin e kimikateve duhet te jete i pajisur me certifikate ADR „PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHMEëë (KIMIKATE) 2.Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave Furnizimi i Hipokloritit te Natriumit do te behet sipas kerkeses se Shoqerise Rajonale Ujesjelles -Kanalizime Sh.a Sarande, por pergjithesisht me sasi propocionale rreth 10.000kg ne menyre periodike, perafersisht cdo dy-tre muaj. Furnizimi do te njoftohet per kete ,7(shtate) dite perpara ne forme shkresore ose elektronike. Ne ndoje rast, furnizuesi duhet te jete i pergatitur qe te plotesoje edhe ndoje kerkesa me urgjente, te Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a “, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. 397/1 prot., datë 29.05.2025, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formular përmbledhës vetëdeklarimi;
- Leje qarkullimi për mjetin me targë AA\*\*\*;
- Dokumentin taksa vjetore e mjeteve lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Certifikatë e kontrollit Teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë AA\*\*\*;
- Certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat të rrezikshme me nr. Certifikte N2-Nd-0003716-004/1, prodhuesi i mjetit Daimler Crysler, me targë AA\*\*\*;
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për mjetin me targë AA\*\*\*.

III.2.2 Në pikën 1 të nenit 77 të LPP-së përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në pikën 3 të nenit 40 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.3 Në nenin 4, pika 2, të ligjit nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” parashikohet: “2. “ADR” janë anekset A dhe B të marrëveshjes europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”, të rishikuar ose të ribotuar, herë pas here, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.”

Ndërsa në nenin 4, pika 7, të ligjit nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” parashikohet: “7. “Certifikatë e miratimit të mjetit, sipas ADR-së” është certifikata e miratimit të mjetit, e lëshuar nga institucionet, sipas nenit 37 të këtij ligji, që vërteton se një mjet i vetëm i destinuar për transportin e disa mallrave të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse, sipas marrëveshjes së përmendur në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji”

Në nenin 12, pika 1, të po këtij ligji parashikohet se: “1. Për transportin e mallrave të rrezikshme përdoret mjeti: a) që është i prodhuar dhe i pajisur në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it; b) për të cilin ka një certifikatë të vlefshme të miratimit, sipas ADR-së, për transportin e disa mallrave të rrezikshme, kur një gjë e tillë specifikohet në dispozitat e ADR-së ose RID-it; c) që është i pajisur me panele (pllakata) dhe është i shënuar në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.”

III.2.4. Në nenin 2, pika 9, të Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007, të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar parashikohet: “9. Certifikatë: dokument që mbahet në mjet dhe që: a) provon zotërimin e licencës për rastet e transporteve rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, që janë subjekt licencimi; b) i jep një mjeti rrugor me motor, të drejtën e operimit në transportet rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, për rastet e transporteve të mallrave për llogari të vet; c) dokument që i jep të drejtën një mjeti për transportin e udhëtarëve, për llogari të vet, brenda dhe jashtë vendit.”

Në pikën 3 të nenit 6 të Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar parashikohet;

### 3. Transporti i mallrave brenda vendit

|                      |                       |                      |
|----------------------|-----------------------|----------------------|
| Lloji i veprimtarisë | Dokumenti që lëshohet | Autoriteti kompetent |
|----------------------|-----------------------|----------------------|

|                                            |                    |                       |
|--------------------------------------------|--------------------|-----------------------|
| <i>Transporti për të tretë dhe me qira</i> | <i>licencë</i>     | <i>Bashkia/qarku,</i> |
| <i>Transporti për llogari të vet</i>       | <i>certifikatë</i> | <i>Bashkia</i>        |
| <i>Transporti i mallrave të rrezikshme</i> | <i>certifikatë</i> | <i>DPSHTRR</i>        |
| <i>Transporti me mjete jashtë norme</i>    | <i>licencë</i>     | <i>DPSHTRR</i>        |

Po këtu, në nenin 31 “Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit” parashikohet: *“Veprimtaria e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme. Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt, fizik ose juridik, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit. Subjekti paraqet: a) Certifikatën e aprovuar për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme të caktuara (sipas ADR), e lëshuar nga DPSHTRR-ja; b) Certifikatën e kontrollit të pajisjes së transportueshme për mallra të rrezikshme, lëshuar nga Instituti i Enëve Nën presion. Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash të rrezikshme, kërkohen dokumentet sipas shkronjave “a” dhe “b”.*

III.2.5. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, pas shqyrtimit të dokumenteve të tenderit, konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, ka kërkuar që Operatori Ekonomik, për automjetin transportues, duhet të paraqesë Certifikatë, ADR, PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME” të lëshuara nga DPSHTRR, kur automjeti është në pronësi të tij, dhe kur automjeti është marrë me qira, përveç certifikates së mësiperme, duhet të paraqesë, Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme deri në përfundim të kontratës. Në rast se operatori ekonomik është importues, atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik, Lejen e Importit të lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasive e kimikateve të percaktuara në DST. Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik, leje mjedisore të tipit A të lëshuar nga QKL, për të gjitha kimikatet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ka dorëzuar formular përmbledhës vetëdeklarimi, ku në pjesën B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) ka deklaruar se disponon në pronësi mjetin me targë AA\*\*\*, nr. shasie WCB \*\*\*. Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP-së nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 397/1 prot., datë 29.05.2025, Komisioni konstaton se, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor Certifikatën e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme, për mjetin me targë AA\*\*\*, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e vlefshme deri më datë 09.08.2028, e cila sipas lex specialis për transportin e mallrave të rrezikshme, është certifikata e lëshuar për mjetin AA\*\*\*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ka paraqitur dokumentacionin me anë të të cilit provon, se disponon certifikatë për mjetin me targë AA\*\*\*, me anë të së cilës dëshmon, se

mjeti plotëson kushtet e përshkruara nga Marrëveshja Europiane, datë 13.12.2012 “Për transportin e Mallrave të Rrezikshme”, lëshuar nga organi kompetent i caktuar me ligj, siç kërkohet në dokumentet e tenderit dhe disponimi i së cilës është një detyrim ligjor në rastet e transportit të mallrave të rrezikshme, referuar kjo në nenin 38 të Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Veprimtaria e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme. Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt, fizik ose juridik, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit.....”.

Sa më sipër, gjykojmë, se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për automjetin për të cilin duhet të kryejë transportin e mallit, i cili sipas legjislacionit në fuqi futet tek mallrat e rrezikshme, ka paraqitur certifikatë për transportin e mallrave të rrezikshme, siç kërkohet në dokumentet e tenderit, të lëshuara nga organi kompetent i ngarkuar me ligj (DPSHTRR).

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “2AT” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e 11 Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “2AT” për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-44265-04-09-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit natriumi për nevojat e shoqërisë”, me fond limit 6,624,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 22-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiovent Zguro**

